EMRI/ Lëvizte me mina dhe eksploziv me vete, pranga 45-vjeçarit në Rrëshen, ja çfarë iu gjet në banesë

07 Prill, 2024 10:15

Madhësia e tekstit:

Një 45-vjeçar nga Rrëshenі ka përfunduar në prangat e policisë.

Blutë bëjnë me dije se pas një informacioni se një shtetas po transportonte mina me telekomandë, në drejtim të Rrëshenit, kanë bërë ndalimin e më pas kontrollin fizik të këtij shtetasi.

Sponsored Links

Me vete i arrestuari, i identifikuar si Arili Kalija, kishte mina me telekomandë te lidhura me aparat celular dhe kallëpe lëndë të dyshuar eksplozive me kapsollë dhe fitil.

Ndërkohë, gjatë kontrolleve në banesën e vjetër të babait të 45-vjeçarit, u gjetën 2 armë zjarri, lëndë eksplozive si ajo që ishte montuar në minat me telekomandë, 10 ndezësa granatash ofensive/defensive, 10 kapsolla detonatore, dhjetëra metra fitil zjarrpërcjellës, si dhe qindra fishekë luftarak.

Njoftimi:

Rrëshen

Parandalohen të tjera ngjarje të rënda kriminale që do të kryheshin me mina me telekomandë.

Policia finalizon operacionin policor të koduar "Safe City 2".

Me mina me telekomandë, eksploziv të lidhur me kapsolla dentonatore dhe lëndë eksplozive, nga Lura drejt Rrëshenit, kapet në flagrancë në hyrje të Rrëshenit, 45-vjeçari nga Lura.

Gjatë kontrollit në banesë në Lurë, Policia i gjeti 2 armë zjarri, lëndë eksplozive, kapsolla detonatore, qindra fishekë luftarak dhe fitil zjarrpërcjellës.

Dy muaj e gjysmë më parë, Policia vuri në pranga një 28-vjecar dhe sekuestroi 2 mina me telekomandë.

Në vijim të operacioneve të njëpasnjëshme për parandalimin e ngjarjeve kriminale, bazuar në inteligjencën policore dhe në zbatim të masave të planit operacional mbarëkombëtar të koduar "Sundimi i ligjit", shërbimet e Komisariatit të Policisë Mirditë siguruan informacion se një shtetas po transportonte mina me telekomandë, në drejtim të Rrëshenit.

Bazuar në këtë informacon organizuan dhe finalizuan me sukses operacionin policor të koduar "Safe City 2", gjatë të cilit, në hyrje të qytetit të Rrëshenit, u kap në flagrancë shtetasi A. K., 45 vjeç, lindur në Thumanë, Krujë.

Gjatë kontrollit fizik të ushtruar ndaj këtij shtetasi, Policia gjeti dhe sekuestroi:

•4 mina me telekomandë te lidhura me aparat celular me lëndë të dyshuara eksplozive;

•5 kallëpe lëndë të dyshuar eksplozive me kapsollë dhe fitil;

•5 kapsolla të lidhura me fitil;

•2 kallepë të tjera lëndë të dyshuar eksplozive.

Në vijim të veprimeve, gjatë kontrolleve në banesën e vjetër të babait të shtetasit të arrestuar, në Lurë, Dibër, shërbimet e Komisariatit të Policisë Mirditë, në bashkëpunim me Policinë e Dibrës, gjetën në banesë 2 armë zjarri, lëndë eksplozive si ajo që ishte montuar në minat me telekomandë, 10 ndezësa granatash ofensive/defensive, 10 kapsolla detonatore, dhjetëra metra fitil zjarrpërcjellës, si dhe qindra fishekë luftarak.

Strukturat hetimore të Komisariatit të Policisë Mirditë, në bashkëpunim me Prokurorinë, vijojnë punën për zbardhjen e plotë të rrethanave të këtij rasti, si dhe për identifikimin dhe arrestimin e shtetasve të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale.

SONDAZH

A mendoni se amnistia e shpërndarëse të vegjël të drogave do ta ulë suksesin e operacionit policor "Tempusilli" për sigurinë rreth shkollave?

- Po
- Jo
- Nuk e di

Voto

Rezultatet

Për t'u bërë pjesë e grupit '**Balkanweb**' mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: dibër hare Rreshen

TË NGJASHME

EMRI/ Theu masën e arrestit shtëpiak, arrestohet 31-vjeçari në Dibër
06 Prill, 2024

Në kërkim për vrasje dhe "Armbajtja pa leje", arrestohet 30-vjeçari në Dibër (EMRI)
22 Mars, 2024

Taboola Feed

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Zgjatja e afateve, sot seancë në GJIKKO për ish-kryeministrin Sali Berisha
08 Prill, 2024

EMRI/ Digjet makina e funksionares së bashkisë së Vlorës
08 Prill, 2024

"Black Eagle", nis sot tjetër proces "SKY ECC" në Belgjikë me 40 të pandehur, drejtuesit e rrjetit shqiptarë
08 Prill, 2024

Zjarr në fshatin Moravë të Beratit, flakët rrezikojnë banesat përreth
07 Prill, 2024

"Mos hidhni inerteт në rrugë dhe mos ndërtoni pa leje", policia në Dhërmi thirrje operatorëve turistikë
07 Prill, 2024

Dhunoi bashkëshorten dhe dy djemtë, arrestohet 61-vjeçari në Devoll
07 Prill, 2024

KATEGORIA VIDEO

Romeo akuzon Meritonin për eliminimin e Ihsës: Ti e doje jashtë!
08 Prill, 2024

VIDEO/ Chelsea zhgënjen në transferitë, Sheffield "1 rrëmben" një pikë në fund
07 Prill, 2024

VIDEO/ Spektakël dhe gola në ndeshjen e "çmendur", Liverpool shmang humbjen ndaj Manchester United
07 Prill, 2024

Protesta në Hungari, Peter Magyar udhëhoqi tubimin, kërkohet dorëheqja e Viktor Orban
07 Prill, 2024

Edhe burgu i Spaçit drejt menaxhimit me fondacion si Butrinti, projekti parashikohet të shkojë 4,2 milionë euro
07 Prill, 2024

Situata e krimit të organizuar, SPAK: Grupet shqiptare luftë për treguet kriminale, rritje e angazhimit të femrave
07 Prill, 2024

App Store Google Play

Kërko këtu

LAJMET E FUNDIT

Romeo akuzon Meritonin për eliminimin e Ihsës: Ti e doje jashtë!
08 Prill, 2024

VIDEO/ Chelsea zhgënjen në transferitë, Sheffield "1 rrëmben" një pikë në fund
07 Prill, 2024

VIDEO/ Spektakël dhe gola në ndeshjen e "çmendur", Liverpool shmang humbjen ndaj Manchester United
07 Prill, 2024

Protesta në Hungari, Peter Magyar udhëhoqi tubimin, kërkohet dorëheqja e Viktor Orban
07 Prill, 2024

Edhe burgu i Spaçit drejt menaxhimit me fondacion si Butrinti, projekti parashikohet të shkojë 4,2 milionë euro
07 Prill, 2024

Situata e krimit të organizuar, SPAK: Grupet shqiptare luftë për treguet kriminale, rritje e angazhimit të femrave
07 Prill, 2024

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2024 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.